

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË  
MARRËVESHJEN KUADËR

PËR:

OPERATORIN EKONOMIK “JUNIK” SHPK, ME ADRESE LAGJJA SMT, NDERTESE 2-  
KATESHE, KATI 2, PRANE DREJTORISE SHERBIMIT PYJOR, LEZHE

BASHKIMIN E OPERATOREVE EKONOMIK “SHPRESA – AL” SHPK & “PEPA GROUP”  
SHPK & “KACDEDJA” SHPK, PERFAQESUAR NGA OE “SHPRESA – AL” SHPK, ME  
ADRESE NJËSIA BASHKIAKE NR. 9, RRUGA "URANI PANO", MBRAPA "VEVE CENTER",  
PALLATI NR. 11, KATI 2, TIRANE

\* \* \*

Procedura e prokurimit: Procedurë e Përshpejtuar – Rindërtimi, e Kufizuar/Pune, “Marrëveshje  
Kuađer”, me disa operatore ekonomik, ku jo të gjithë kushtet janë të përcaktuara.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-09565-10-26-2021

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Riforcimi dhe Rikonstruksioni i Biblotekes "Gjergj Fishta" dhe  
Pallatit te Kultures "Dede Ndue Lazri", ne Bashkine Lezhe”.

Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuađer: 12 Muaj nga data e nënshkrimit te marrëveshjes Kuader.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]  
Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: X oferta ekonomikisht më e favorshme  çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë:

1- Operatori Ekonomik “AGI KONS” Shpk, me Nuis K21622001M,

2- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “CURRI” Shpk, me Nuis J67902718S & “BE-IS” Shpk, me  
Nuis K71412003A,

3- Operatori Ekonomik “JUNIK” Shpk, me Nuis J68007522L,

4- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “LEON KONSTRUKSION” Shpk, me Nuis K71820009I &  
“ERGI” Shpk, me Nuis K02727229P,

5- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “SIRETA 2F” Shpk, me Nuis K51501008J & “AGRI  
KONSTRUKSION” Shpk, me Nuis K01725001F,

6- Bashkimi Operatoreve Ekonomik “SHPRESA – AL” Shpk, me Nuis K31321021N & “PEPA GROUP” Shpk, me Nuis L42215009L & “KACDEDJA” Shpk, me Nuis K51712017A,

7- Operatori Ekonomik “STERKAJ” Shpk, me Nuis J68310708M,

*Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:*

- Operatori Ekonomik “AGI KONS” Shpk, me Nuis K21622001M,

- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “CURRI” Shpk, me Nuis J67902718S & “BE-IS” Shpk, me Nuis K71412003A,

- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “LEON KONSTRUKSION” Shpk, me Nuis K71820009I & “ERGI” Shpk, me Nuis K02727229P,

- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “SIRETA 2F” Shpk, me Nuis K51501008J & “AGRI KONSTRUKSION” Shpk, me Nuis K01725001F,

- Operatori Ekonomik “STERKAJ” Shpk, me Nuis J68310708M,

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- Operatori Ekonomik “AGI KONS” Shpk, me Nuis K21622001M, nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se:

*Se pari*, nuk ploteson kriterin nuk ploteson kriterin 2.1/b, te kriterëve të vecanta të kualifikimit ku parashikohet se OE duhet të paraqesin: *Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 4*, pasi nga verifikimi në SPE rezulton se operatoriekonomik nuk ka plotësuar sipas kërkesave ligjore pikën 6 të kesaj shtojce në të cilën duhet të klikonte një nga alternativat, konkretisht si më poshte:

6. *Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):*

a) *Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;*

b) *Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).*

Ndërsa në pikën dy të kesaj shtojce parashikohet se:

2. *Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimet publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;*

Gjithashtu ne DST, kapitulli II.UDHËZIME PËR OPERATORËT EKONOMIKË, Seksioni 1. Hartimi i kërkesës/ofertës parshikohet se:

*1.1 Kandidatët/Ofertuesit janë të detyruar të përgatisin kërkesën/ofertën, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Kërkesat/Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme.*

Sa me sipër Komisioni i Vleresimit të Ofertave verën se operatori ekonomik ka dorezuar një deklaratë që nuk është e plotë dhe bazuar në pikën 2, të Deklaratës për paraqitje oferte të pavarur sipas shtojcës 4 ky kriter konsiderohet i papermbushur.

Se dyti, nuk plotëson kriterin 2.2.3, të kriterëve të vecanta të kualifikimit ku parashikohet se operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet për vitin 2021 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afatëve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2021.

KVO verën se për permbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik bazuar në ekstratin e QKB-se, duhet të dorëzojë vërtetim nga Bashkitë Tirane, Durrës, Berat dhe Krujë.

Nga verifikimi në SPE rezulton se operatori ekonomik ka paraqitur vërtetim për pagesën e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore për Bashkitë Tirane, Durrës dhe Berat, ndërsa për Bashkinë Krujë dokumenti me titull *Vërtetim\_taksa\_bashkia\_Fushe\_Kruje*, nuk rezulton i dorëzuar sipas formatit të kërkuar në SPE, pasi përmbajtja e këtij dokumenti nuk është e aksesueshme nga ana e KVO-se.

Theksojmë se ngarkimi i dokumenteve në sistem është përgjegjësi e operatorit ekonomik, si dhe duhet të kryhet sipas udhëzimeve që APP ka publikuar lidhur me ngarkimin e dokumenteve dhe ruajtjen e tyre në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

Sa me sipër ky kriter konsiderohet i papermbushur.

Se treti, nuk plotëson kriterin 2.3.7 të kriterëve të vecanta të kualifikimit ku parashikohet se operatori Ekonomik duhet të disponojë mjetet e mëposhtme (Shtojca 13) :

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamion me kapacitet mbajtes mbi 20 ton	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	1
2	Kamion me kapacitet mbajtes 10-15 ton	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	2
3	Kamionçina me kapacitet deri në 5 ton	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	3
4	Kamion me vinç	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	1
7	Betoniere kantieri	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	4

8	Elektrosladatrice	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	1
9	Gjenerator saldimi	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	1
10	Gjenerator	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	1
11	Impiant prodhimi i betonit	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	1

- Kokore +Jeleke fosforoshente, minimumi 80 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 6 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 5 copë
- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 5 copë

Per te deshmuar kete, Formulari i shtojces te DST duhet te shoqerohet me dokumentat e meposhtme:

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë ne pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojnë pronesinë e mjetit:- çertifikatën e pronesisë; -leja e qarkullimit; -çertifikatën e kontrollit teknik; - siguracionin; - taksat vjetore- leja e transportit, si dhe të paraqesë foto të qarte për secilin mjet dhe të jetë e dukshme targa e mjetit.
- Ndersa per mjete te marra me qera/kontrate bashkepunimi krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerese/ bashkëpunimit.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë ne pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese, ndersa per mjete te marra me qera/ Kontrate bashkëpunimi, krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qeras/ Kontrate Bashkepunimi.
- Për impiantin e prodhimit e betonit ne rast se eshte ne pronesi duhet te paraqiten dokumente qe vertetojne pronesine e saj, (Leje shfrytezimi, plane vendosje, leje mjedisore, QKL Kodi III.1.B) dhe dokumentacion qe verteton pronesine.Ne rast se impianti i prodhimit te betonit, eshte me qera ose kontrate bashkepunimi duhet te paraqitet kontrata e qerese/bashkëpunimit.

*(KVO do te verifikojë nepermjet QKB nese impianti i prodhimit te Betonit eshte i pajisur me license 3.1.B te impiantit te betonit, ne rast te kundert OE do te skualifikohet).*

KVO veren se per permbushjen e ketij kriteri operatori ekonomik duhet te paraqese mjetet e kerkuara te shoqeruara me dokumentacionin e vlefshem te kerkuar.

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se kamioni me kapacitet mbajtes mbi 20 ton me targe AA 701 OZ nuk disponon leje transporti te vlefshme, pasi leja e transportit e paraqitur nga OE per kete kamion ka skaduar me daten 18.10.2021.

Sa me siper ky kriter konsiderohet i papermbushur.

*Se katerti, nuk permbush piken 2.3.14, te kriterëve te vecanta te kualifikimit ku parashikohet se Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve dhe pajisjeve sipas shtojces 13, ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor (KVO). (Mos plotesimi i ketij kriteri perben kusht per skualifikim), pasi nga verifikimi ne SPE rezulton se*

Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur deklarate mbi vendodhjen e mjeteve dhe pajisjeve sipas shtojces 13.

Sa me sipër Komisioni i Vleresimit të Ofertave mbështetur nën 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e OE “AGI KONS” SH.P.K, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

*Si përfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “AGI KONS” SH.P.K, skualifikohet.*

- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “CURRI” Shpk, me Nuis J67902718S & “BE-IS” Shpk, me Nuis K71412003A, nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se:

Ne pikën 1/c, të kushteve të veçanta të kualifikimit, të Dokumentet Standart të Tenderit, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 225, datë 12.04.2021 “Për një ndryshim në vendimin nr. 199, datë 04.03.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e dokumenteve standarde të procedurës së prokurimit, të kriterëve të vleresimit të ofertës fituese, kushteve të marrëveshjes kuader dhe të kontratës për procesin e rindërtimit”, të ndryshuar dhe dokumentet standarde të procedurës në kuader të procesit të rindërtimit”, parashikohet se:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë: *c. Sigurim oferte sipas Shtojcës 5;*

Gjithashtu në nenin 83, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet se: *1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës në të gjitha*

*llojet e procedurave të prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, ndërkohë që mund të kërkojë paraqitjen e këtij sigurimi edhe në procedurat nën kufirin e lartë monetar, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.*

Si dhe ne nenin 30, të VKM-se 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet se: *“Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, sikurse përcaktohet në nenin 83, të LPP-së. Enti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, sikurse përcaktohet në nenin 83, të LPP-së. Enti kontraktor, sipas vlerësimit të tij, mund të kërkojë ose jo sigurim oferte për procedurat nën kufirin e lartë monetar.2. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor pranon mundësinë e pagesës së vlerës së sigurimit, nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit/entit kontraktor. Përveç kësaj forme të paraqitjes së sigurimit të ofertës, sigurimi i ofertës mund të ketë formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi, e licencuar nga shteti për të ushtruar këtë veprimtari”*,

Sa me sipër KVO, vlereson se për të përmbushur këto kriter OE-te duhet të paraqesin sigurimin e ofertës në formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi e cila duhet të jete e neshkuar nga Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit.

Per me tepër ky kriter veçanërisht është i shtuar në procedurat në kuader të procesit të rindertimit dhe është vendosur nga autoritetet perkatese në DST, të kriteret e vecanta (shtojcat), të cilat nuk mund të ndryshohen nga autoritetet kontraktore. Mospermbushja e këtyre kriterëve përben shkak për skualifikimin e ofertuesve.

Nga verifikimi i dokumentacionit në SPE, rezulton se BOE nuk ka ngarkuar në SPE sigurimin e ofertes sipas shtojces 5, duke e bërë të pa përmbushur këto kriter.

*Se dyti në pikën 1/gj, të kushteve të veqanta parashikohet se: Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë: Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri*

KVO verën se, për përmbushjen e këtij kriteri Operatoret Ekonomik duhet të paraqesin Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike përfshirë ku në rastin konkret përfshihet edhe muaji Shtator 2021.

Autoriteti Kontraktor vëren se:

1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se në përmbushje të kriterit sa më sipër anëtari i bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë “CURRI” SH.P.K ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Vërtetim Debie Nr.OSHEE-2021-3522748-YN, datë 25/ 10/ 2021 me anë të së cilës vërtetohet se kërkuesi CURRI SH.P.K nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratat (me kod), (lista bashkelidhur), titullar/përdorues i të cilave është Curri Shpk, rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 25.10.2021, pa përfshirë faturën koherente të muajit Shtator 2021.

1.3. Në nenin 39, “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 7 të, VKM-se 285, date 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht: *Për të provuar se operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që: a) Operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.*

1.4. Në nenin 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me Vendimin e ERE nr.109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jo familjarë”, përcaktohet shprehimisht që: *“Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.*

1.5. Autoriteti Kontraktor vlereson se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

1.6. Referuar sa më sipër nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se anëtari i bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë “CURRI” shpk ka dorëzuar vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike pa përfshirë detyrimet e maturuara të muajit Shator 2021. Nga verifikimet në SPE, rezulton se në datën 15.11.2021 autoriteti kontraktor, ka zhvilluar fazën e parë të procedurës së mësipërme të prokurimit (shprehja e interesit). Referuar datës së zhvillimit të fazës së parë të procedurës së prokurimit objekt ankimi datë 15.11.2021, Autoriteti Kontraktor vlereson se detyrimet e energjisë elektrike për muajin shtator 2021 janë tashmë të maturuara në kuptim të përcaktimeve ligjore sa më sipër dhe afati i fundit për shlyerjen e tyre ka qenë data 31.10.2021. Në këtë kuptim referuar datës së zhvillimit të fazës së parë të procedurës së prokurimit objekt ankimi (15.11.2021), AK vlereson se, anëtari i bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë “CURRI” shpk, nuk ka plotësuar kriterin e veçante të kualifikimit lidhur me shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike, në përputhje me përcaktimet në dispozitat ligjore/nënligjore në fuqi.

Autoriteti kontraktor venen se te njejtin qendrim ka mbajtur Komisioni i Prokurimit Publik ne vendimin nr. 126/2021 lidhur me nje ceshtje analoge.

*Si rrjedhoje ky kriter konsiderohet i pa përmbushur nga ana e OE.*

Se treti, nuk ploteson kriterin 2.2.10 te kriterëve te vecanta te kualifikimit ku parashikohet se: Operatori ekonomik ne rast se nuk eshte prodhues duhet te paraqese kontrat e furnizimit per materialet si me poshte:

2.2.10/1 Per Bojrat

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Kontrata duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.

2.2.10/2 Per Pllakat dhe Parketin

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Kontrata duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.

2.2.10/3 Materialet e termoizolimit dhe suvase (Polisterol, Rrjete, Grafiato, Llaç, Fino) :

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Kontrata duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.

2.2.10/4 Materialet hidroizoluese (Katrama, Hidroizolues bikomponent)

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Kontrata duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave veren se per permbushjen e ketij kriteri operatorët ekonomike duhet te paraqesin per secilin nga materialet e kerkuar kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Kontrata duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.

Nga verifikimi ne SPE rezulton se per Pllakat dhe Parketin operatori ekonomik ka paraqitur kontrate furnizimi me nje operator (furnizues) i cili nuk eshte prodhues. Ne kontraten e paraqitur mungojne te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website.

KVO duke pasur ne konsiderate se te gjithë prodhuesit e kane detyrim ligjor pajisjen me leje mjedisore nga QKL, beri nje kerkim ne faqen zyrtare qkb.gov.al, ku rezultoi se furnizuesi per Pllakat dhe Parketin nuk disponon QKL si prodhues.

Sa me siper duke qene se furnizuesi nuk disponon QKL si prodhues si dhe duke qene se ne kontraten e furnizimit te paraqitur nga OE mungojne te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, ky kriter konsiderohet i papermbushur.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshetur nenin 76, pika 3/a dhe ne nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;b) gjendjen ekonomike dhe financiare;c) aftësinë teknike dhe profesionale.Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet



nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në bazuar në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik “CURRI” Shpk & “BE-IS” Shpk, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

*Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “CURRI” Shpk & “BE-IS” Shpk, skualifikohet.*

- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “LEON KONSTRUKSION” Shpk, me Nuis K71820009I & “ERGI” Shpk, me Nuis K02727229P, nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se:

Se pari, nuk plotëson kriterin 2.3.5 të kriterëve të vecanta të kualifikimit ku parashikohet se: Krahas stafit teknik Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar staf mbështetës si me poshtë:

- Ing. Ndertimi	1 (nje)	Diplome Universitare
- Teknik Ndertimi	1 (nje)	Diploma të shkolles së mesme
- Teknik Hidraulik	1 (nje)	Diploma të shkolles së mesme
- Teknik Elektrik	1 (nje)	Diploma të shkolles së mesme
- Hidraulik	1 (nje)	Certifikate trajnimi ose Deshmi Profesionale
- Elektricitist	3 (tre)	Certifikate trajnimi ose Deshmi Profesionale
- Suvatues	4 (kater)	Certifikate trajnimi ose Deshmi Profesionale
- Bojaxhi	4 (kater)	Certifikate trajnimi ose Deshmi Profesionale
- Murator	2 (dy)	Certifikate trajnimi ose Deshmi Profesionale
- Hekurkthyes	2 (dy)	Certifikate trajnimi ose Deshmi Profesionale
- Kapertier	2 (dy)	Certifikate trajnimi ose Deshmi Profesionale
- Saldador	2 (dy)	Certifikate trajnimi ose Deshmi Profesionale
- Shofer	2 (dy)	Cert.trajnimi/Deshmi Profesionale/Leje
Drejtimi		

Operatori ekonomik duhet të paraqes për stafin e mesiperm: Kontratat individuale të punës, Diplome Universitare/ Diplome të Shkolles së Mesme/ Certifikatat e Trajnimeve/ Deshmitë profesionale/ Leje Drejtimi sipas shënimeve për çdo kategori të mesipërme si dhe stafi i mesiperm të figurojë në listepagesat e shoqërisë për periudhën Qeshor 2021 - Gusht 2021.

Nga verifikimi në SPE rezulton se asnjë nga punonjësit e paraqitur nga BOE si stafi mbështetës nuk disponon Diplome të Shkolles së Mesme si Teknik Hidraulik.

*Sa me sipër ky kriter konsiderohet i papërmbushur.*

Se dyti nuk ploteson kriterin 2.2.10 te kriterëve te vecanta te kualifikimit ku parashikohet se Operatori ekonomik ne rast se nuk eshte prodhues duhet te paraqese kontrat e furnizimit per materialet si me poshte:

#### 2.2.10/1 Per Bojrat

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Kontrata duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.

#### 2.2.10/2 Per Pllakat dhe Parketin

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Kontrata duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.

#### 2.2.10/3 Materialet e termoizolimit dhe suvase (Polisterol, Rrjete, Grafiato, Llaç, Fino) :

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Kontrata duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.

#### 2.2.10/4 Materialet hidroizoluese (Katrama, Hidroizolues bikomponent)

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Kontrata duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave veren se per permbushjen e ketij kriteri operatoret ekonomike duhet te paraqesin per secilin nga materialet e kerkuar: Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Kontrata duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.

Nga verifikimi ne SPE rezulton se per Pllakat dhe Parketin, si dhe Materialet hidroizoluese (Katrama, Hidroizolues bikomponent) BOE ka paraqitur kontrate furnizimi me operator (furnizues) te cilet nuk jane prodhues. Ne kontratat e paraqitur mungojne te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website.

KVO duke pasur ne konsiderate se te gjithë prodhuesit e kane detyrim ligjor pajisjen me leje mjedisore nga QKL, beri nje kerkim ne faqen zyrtare qkb.gov.al, ku rezultoi se furnizuesit per Pllakat dhe Parketin, si dhe per Materialet hidroizoluese (Katrama, Hidroizolues bikomponent), nuk disponojne QKL si prodhues.

Sa me siper duke qene se furnizuesit nuk disponojne QKL si prodhues si dhe duke qene se ne kontratat e furnizimit per Pllakat dhe Parketin, si dhe per Materialet hidroizoluese (Katrama, Hidroizolues bikomponent), te paraqitur nga BOE mungojne te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, ky kriter konsiderohet i papermbushur.

Se treti, nuk ploteson kriterin f. *Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve/makinerive sipas Shtojcës 13 dhe* kriterin 2.3.12 te kriterëve te vecanta te kualifikimit ku parashikohet se Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaroi se mjetet dhe pajisjet e deklaruara sipas shtojcës 13, nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera. *(Mos plotesimi i ketij kriteri perben kusht per skualifikim).*

Komisioni i Vleresimit te ofertave veren se per permbushjen e ketyre kriterave operatoret ekonomike duhet te deklarojne disponueshmërinë e mjeteve/makinerive si dhe keto mjete/makineri te deklaruar ne shtojcen 13 nuk duhet te jenë të angazhuara në kontrata të tjera.

Nga verifikimi ne SPE rezulton se kane paraqitur: Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve/makinerive sipas Shtojcës 13, si dhe deklarata me anë të së cilës deklarohen se mjetet dhe pajisjet e deklaruar sipas shtojcës 13, nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera te dy anetaret e Bashkimit te Operatoreve Ekonomik.

KVO rastesisht gjate vleresimit te procedures se prokurimit me numer reference REF-09564-10-26-2021, konsatoi se njeri nga operatoret ekonomike te ketij BOE, konkretisht OE ERGI SH.P.K ka nenshkruar kontrate noteriale qiraje me nr.rep 10963 dhe Nr. Koleksioni 4189, date 23.09.2020, per dhenien me qira te dy mjeteve me targa AA 211 VS; AA 367 HC, per nje periudhe 2- vjecare.

KVO veren se keto mjete te dhena me qira me target e siper shenuara jane te deklaruar nga OE ERGI SH.P.K, ne shtojcen 13 si mjete ne dispozicion per realizimin e kontrates.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave referuar VKM-senr. 225, date 12.04.2021 "Per nje ndryshim ne vendimin nr. 199, date 04.03.2020, te Keshillit te Ministrave, "Per miratimin e dokumenteve standarde te procedures se prokurimit, te kriterave te vleresimit te ofertes fituese, kushteve te marreveshjes kuader dhe te kontrates per procesin e rindertimit", te ndryshuar dhe dokumentet standarde te procedures ne kuader te procesit te rindertimit ne pjesen: II. UDHËZIME PËR OPERATORËT EKONOMIKË, Seksioni 1. Hartimi i kërkesës/ofertës, parashikohet si me poshte:

*1.5 Operatori ekonomik, mban përgjegjësi për të gjithë dokumentacionin e paraqitur si pjesë e ofertës. Në rast verifikimi të përmbajtjes së dokumentacionit të paraqitur, apo të vetëdeklarimeve, kur përmbajtja e tyre nuk rezulton e vërtetë, operatori ekonomik ndodhet në kushtet e parashikuara në nenin 78, pika 1, gërma (a) të LPP-së.*

Si dhe ne piken 5, te neni 76 te LPP, Kriteret detyruese për skualifikim parashikohet se:

*5. Autoriteti ose enti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji.*

*Sa me siper KVO vlereson kete kriter si te papermbushur.*

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;b) gjendjen ekonomike dhe financiare;c) aftësinë teknike dhe profesionale.Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të

përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën eBOE “LEON KONSTRUKSION” Shpk & “ERGI” Shpk, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

*Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, BOE “LEON KONSTRUKSION” Shpk & “ERGI” Shpk, skualifikohet.*

- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “SIRETA 2F” Shpk, me Nuis K51501008J & “AGRI KONSTRUKSION” Shpk, me Nuis K01725001F, nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se: Se pari, nuk plotëson kriterin 2.3.5, të kriterëve të vecanta të kualifikimit ku parashikohet se: Krahas stafit teknik Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar staf mbështetës si me poshtë:

- Ing. Ndertimi	1 (nje)	Diplome Universitare
- Teknik Ndertimi	1 (nje)	Diploma të shkolles së mesme
- Teknik Hidraulik	1 (nje)	Diploma të shkolles së mesme
- Teknik Elektrik	1 (nje)	Diploma të shkolles së mesme
- Hidraulik	1 (nje)	Certifikate trajnimi ose Deshmi Profesionale
- Elektracist	3 (tre)	Certifikate trajnimi ose Deshmi Profesionale
- Suvatues	4 (kater)	Certifikate trajnimi ose Deshmi Profesionale
- Bojaxhi	4 (kater)	Certifikate trajnimi ose Deshmi Profesionale
- Murator	2 (dy)	Certifikate trajnimi ose Deshmi Profesionale
- Hekurkthyes	2 (dy)	Certifikate trajnimi ose Deshmi Profesionale
- Kapertier	2 (dy)	Certifikate trajnimi ose Deshmi Profesionale
- Saldador	2 (dy)	Certifikate trajnimi ose Deshmi Profesionale
- Shofer	2 (dy)	Cert.trajnimi/Deshmi Profesionale/Leje
Drejtimi		

Operatori ekonomik duhet të paraqes për stafin e mesiperm: Kontratat individuale të punës, Diplome Universitare/ Diplome e Shkolles së Mesme/ Certifikatat e Trajnimeve/ Deshmitë profesionale/ Leje Drejtimi sipas shënimeve për çdo kategori të mesipërme si dhe stafi i mesiperm të figurojë në listepagesat e shoqërisë për periudhën Qeshor 2021 - Gusht 2021.

Nga verifikimi në SPE rezulton se asnjë nga punonjësit e paraqitur nga BOE si stafi mbështetës nuk disponon Diplome të Shkolles së Mesme si Teknik Hidraulik.

*Sa me sipër ky kriter konsiderohet ipapermbushur.*

Se dyti nuk ploteson kriterin 2.2.10 te kriterëve te vecanta te kualifikimit ku parashikohet se Operatori ekonomik ne rast se nuk eshte prodhues duhet te paraqese kontrat e furnizimit per materialet si me poshte:

2.2.10/1 Per Bojrat

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Kontrata duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.

2.2.10/2 Per Pllakat dhe Parketin

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Kontrata duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.

2.2.10/3 Materialet e termoizolimit dhe suvase (Polisterol, Rrjete, Grafiato, Llaç, Fino) :

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Kontrata duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.

2.2.10/4 Materialet hidroizoluese (Katrama, Hidroizolues bikomponent)

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Kontrata duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave veren se per permbushjen e ketij kriteri operatorët ekonomike duhet te paraqesin per secilin nga materialet e kerkuar: Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Kontrata duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.

Nga verifikimi ne SPE rezulton se perMaterialet hidroizoluese (Katrama, Hidroizolues bikomponent) BOE ka paraqitur kontrate furnizimi me operator (furnizues) i cili nuk eshte prodhues.

Ne kontraten e paraqitur mungojne te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website.

KVO duke pasur ne konsiderate se te gjithë prodhuesit e kane detyrim ligjor pajisjen me leje mjedisore nga QKL, beri nje kerkim ne faqen zyrtare qkb.gov.al ku rezultoi se furnizuesi per Materialet hidroizoluese (Katrama, Hidroizolues bikomponent) nuk disponon QKL si prodhues.

Nga verifikimi ne SPE verehet se bashkengjitur kontrates se furnizimit, BOE ka paraqitur nje dokument ne gjuhen angleze, te paperkthyer ne gjuhen shqipe.

KVO veren se ne piken 2, te nenit 24, te VKM-se 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet se:

*2. Në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, dokumentet e tenderit duhet të hartohen në gjuhët shqip dhe anglisht. Operatorët ekonomikë mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht. Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe. Në këto procedura, në raste specifike, nëse autoriteti/enti kontraktor e gjykon të nevojshme, mund të hartojë dokumentet e tenderit në gjuhët shqip dhe anglisht dhe njofton operatorët ekonomikë se mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht.*

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik ne vendimin nr. 825/2021, mban te njejtin qendrim ne te cilin theksohet se: *“II.4.4. Komisioni i Prokurimit Publik, referuar përcaktimeve ligjore mbi përdorimi e gjuhës shqipe në dokumentet e tenderit, për të qenë sa më të kuptueshme për palët dhe për të krahasuar përputhshmërinë e parametrave dhe të dhënave të mallit që prokurohet, është e nevojshme që për artikujt, objekt-prokurimi, të dhënat e katalogut të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe, gjuhë e përdorur në dokumentet e procedurës së prokurimit. Në këtë kuptim KPP gjykon, se autoriteti kontraktor ka hartuar kriterin në përputhje me dispozitat ligjore dhe kriteri nuk le vend për konfuzion”*.

Sa me siper duke qene se furnizuesi nuk disponon QKL si prodhues, ne kontraten e furnizimit per Materialet hidroizoluese (Katrama, Hidroizolues bikomponent), te paraqitur nga BOE mungojne te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, si dhe BOE nuk ka paraqitur nje autorizim prodhuesi te perkthyer ne gjuhen shqipe, ky kriter konsiderohet i papermbushur.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;b) gjendjen ekonomike dhe financiare;c) aftësinë teknike dhe profesionale.Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe ne në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi te refuzoje oferten eBOE “SIRETA 2F” Shpk & “AGRI KONSTRUKSION” Shpk,per mos permbushje te kriterëve te vecanta kualifikuese.

*Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, BOE “SIRETA 2F” Shpk & “AGRI KONSTRUKSION” Shpk, skualifikohet.*

- Operatori Ekonomik “STERKAJ” Shpk, me Nuis J68310708M, nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se:

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se OE:Nuk ploteson asnje nga kriteret e vecanta te kualifikimit.

Sa me sipër Komisioni i Vleresimit të Ofertave mbështetur nën 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nën 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e OE “STERKAJ” Shpk, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

*Si përfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “STERKAJ” Shpk, skualifikohet.*

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm për lidhjen e marrëveshjes kuadër:

- Operatori Ekonomik “JUNIK” Shpk, me Nuis J68007522L,

- Bashkimi Operatoreve Ekonomik “SHPRESA – AL” Shpk, me Nuis K31321021N & “PEPA GROUP” Shpk, me Nuis L42215009L & “KACDEDJA” Shpk, me Nuis K51712017A,

*Shënim: Referuar VKM nr.225, datë 12.04.2021 “Për miratimin e dokumenteve standarde të procedurës së prokurimit, të kriterëve të vlerësimit të ofertës fituese kushteve të marrëveshjes kuadër dhe të kontratës për procesin e rindërtimit”, kualifikimi i ofertuesëve në fazën e parë, nuk është me pikë.*

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë Bashkisë Lezhe se bashku me dokumentacionin e noterizuar të ofertës tuaj, brenda 3 (tre) ditëve nga dita e marrjes/ publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 24/11/2021

Ankesa: Nuk Ka